



MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR



AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS

Raport për monitorimin e cilësisë së ajrit në Komunën e Drenasit

Dhjetor 2015

Page 1 of 8



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK-MMPH)
Adresa: Rruga "Luan Haradinaj" Ndertesa e Re e Qeverise, kati XV/04, 10000 Prishtinë
Tel. 03820033228, e-mail&web: KEPA@rks-gov.net, www.ammk-rks.net

GJENDJA E PËRGJITHSHME E MONITORIMIT TË CILËSISË SË AJRIT

Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) konkretisht Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) bënë monitorimin e cilësisë së ajrit në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përmes Rrjetit Nacional për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit.

Rrjeti Nacional i Monitorimit të Cilësisë së Ajrit është i përbërë nga 12 stacione automatike fikse dhe një stacion automatik mobil.

Shpërndarja e stacioneve dhe përzgjedhja e lokacioneve monitoruese është bërë konform kriterëve të **Direktivës 2008/50/EU për ajër të pastër ne Evropë**, dhe duke respektuar këto kriterë stacionet janë shpërndarë në 9 (nëntë) komuna të Kosoves: Prishtinë, Obiliqit, Drenas, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Brezovicë, Hani i Elezit dhe Gjilan (shih hartën ne fig.1.).

Në këto stacione monitorohen parametrat ndotës: SO₂, CO, NO₂, O₃, PM10 dhe PM2.5.




Fig.1 Rrjeti nacional i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë

MONITORIMI I CILËSISË SË AJRIT NË KOMUNËN E DRENASIT

Skiru është përmedur më lartë AMMK konkretisht IHMK monitoron cilësinë e ajrit në zonën e Drenasit përmes:

- ✓ 1 stacion automatik fiks;
- ✓ 1 stacion mobil, Mars 2015- O₃, NO₂ dhe
- ✓ 4 lokacione monitoruese me pajisje portabël, nga 01.10.2015- PM10 dhe metalet e rënda në PM10 (Cd, Cr, Ni, Pb, Fe, Zn, As, Hg)

Në stacionin fiks me matje automatike monitorohet nga Janari i 2015. Parametrat e monitoruar janë: PM10, PM2.5, SO₂ ndërsa nga shtatori i 2015 këtij stacioni i janë shtuar edhe analizë për monitorimin e NO₂, O₃ dhe CO që në total nga ky stacion tani monitorohen: PM10, PM2.5, SO₂, NO₂, O₃ dhe CO.

Në stacionin mobil me matje automatike monitorohet nga Marsi i 2015. Parametrat e monitoruar janë: NO₂ dhe O₃.

Ndërsa nga 1 tetor 2015 ka filluar projekti për **“Monitorimi i PM10 në ajër dhe përcaktimi i metaleve të rënda në PM10 në zonën e Drenasit”**. Projekti është duke u financuar nga UNDP dhe përmes këtij është zgjeruar monitorimi i cilësisë së ajrit në këtë zonë, ku janë përcaktuar 4 lokacione të reja për monitorimin e PM10 dhe përqendrimin e metaleve të rënda në PM10.

Shpërndarja e lokacioneve monitoruese është bërë në bazë të treëdafililit të erës dhe është rrethuar e gjithë zona e Feronikelit me stacione monitoruese (shih fig2.).

Lokacionet e monitorimit të paraqitur në hartën e poshtëshenuar janë: monitorimi me stacionin fiks- Oborri i Komunës, Stacioni mobil, oborri i zjarrëfikësve dhe 4 lokacionet me monitorim përmes pajisjeve portabël: Lagja e Feronikelit, Çikatova e Re, Çikatovë e Vjeter dhe Gllobar

Mostrat e mbledhura nga 4 lokacionet e monitorimit përmes sistemit me pajisje portabël do të dërgohen për analizë në një laborator të akredituar jashtë vendit i cili kontraktohet nga UNDP (donacion për IHMK/AMMK) në mënyrë që të kemi rezultate më të besueshme. Rezultatet nga monitorimi përmes projektit të mbështetur nga UNDP do të publikohen në fund të projektit (Maj 2016).




Fig.2. Lokacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit në Drenas

Metodat dhe pajisjet monitoruese

Gjatë monitorimit të cilësisë së ajrit për përcaktimin e përqendrimeve të ndotësve në ajër janë përdorur metoda standarde për matjen e ndotësve në ajër të cilat janë:

- ✓ SO₂: EN 14212- ultraviolet fluorescence
- ✓ NO₂ dhe NO_x: EN 14211- Kemiluminescence
- ✓ CO : EN 14626- Spektroskopi infrared (infra e kuqe) jo disperzive
- ✓ O₃: EN 1462 - fotometri ultraviolet
- ✓ PM₁₀ : EN 12341- beta attenuation (Sharp) dhe optical measures (Grimm M180)
- ✓ PM₁₀: EN 12341- gravimetri dhe
- ✓ Përcaktimi i metaleve të rënda në PM₁₀ - ICP-MS



Fig.3 Analizerët brenda stacionit automatik monitorues dhe pajisja portabël

Rezultatet nga monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së ajrit në zonën e Drenasit

Rezultatet e mbledhura nga matjet automatike të parametrave ndotës të ajrit përpunohen, validohen dhe behet analiza e tyre për të dhënë një vlerësim të gjendjes së cilësisë së ajrit në zonën e monitorimit.

Vlerësimi i gjendjes së cilësisë së ajrit bëhet duke bërë krahasimin e vlerave të rezultateve të fituara me vlerat standard të lejuara sipas ligjeve dhe rregulloreve vendore në fuqi dhe sipas Direktivës 2008/50 EC për ajër të pastër në Evropë.

Nga rezultatet e paraqitura në grafikun në vijim (fig.4) vërehet se ka pasur tejkalime të vlerave ditore të lejuara me PM₁₀ (50 ug/m³), ku vlera maksimale e regjistruar arrijnë në 151,47 ug/m³ në muajin Nëntorë.

Nëse e krahasojmë muajin Nëntor me muajt e tjerë për periudhën që është duke u shqyrtuar, vërehet një ngritje e theksuar e përqendrimit të PM10 në ajër gjatë muajit Nëntorë dhe vetëm gjatë këtijë muaji janë regjistruar 18 raste (dite) me tejkalime të vlerave mesatare ditore të lejuara (VMDL).

Në ngritjen e përqendrimit të PM10 në ajër, kontribuojnë shkarkimet nga: transporti, industria, përdorimi i lëndëve djegëse për ngrohje dhe shumë aktivitetet tjera antropogjene.

Përdorimi i lëndëve djegëse për ngrohje sikur jana druri dhe thëngjilli (të cilat i konsumon shumë zona e Drenasit) kontribuojnë në rritjen e përqendrimit të PM10 në ajër gjatë muajve Nëntor-Mars kur teperaturat e ajrit biejnë dhe rritet nevoja e konsumimit të tyre.




Fig.4. Vlerat ditore te Perqendrimit te PM10 gjate sezonit dimrore dhe vjeshtore

Në grafikun e poshtë shënuar (fig.5) janë paraqitur vlerat mesatare mujore të përqendrimit të PM10, PM2.5 dhe numri i ditëve me tejkalime të vlerave ditore gjatë periudhës së monitorimit. Nga vlerësimi i të dhënave të paraqitura në grafikun e poshtëshënuar vërejmë se në muajin Nëntor kemi ngritje të theksuar të përqendrimit të PM10, PM2.5 dhe numrit të ditëve me tejkalime. Vlera maksimale e mesatares mujore arrinë në 108.63 gjatë muajit Nëntor, po ashtu edhe vlera mesatare mujore e PM2.5 ka ngritje të theksuar gjatë Nentorit. Vlera maksimale e mesatares mujore të PM2.5 arrinë në 71.62 ug/m3.

Numri i ditëve me tejkalime brenda periudhës kur kemi rezultate nga monitorimi i PM10, arrinë në 45 raste (ditë) me tejkalime të vleres ditore që d.m.th se tejkalohet numri i ditëve të lejuara me tejkalime brenda vitit (35 ditë brenda vitit).




Fig.5. Vlerat e mesatareve mujore te perqendrimit te PM10

Është karakteristikë se gjatë gjithë periudhës sa monitoron IHMK në këtë zonë nuk janë paraqitur raste me tejkalime të ndotësve të gaztë sikur jana SO₂, NO₂, dhe CO me përjashtim të 2 rasteve me tejkalime ditore të O₃. Po ashtu edhe për periudhën që tani jemi duke e shqyrtuar në këtë raporte nuk janë paraqitur raste me tejkalime të vlerave standard të lejuara me ndotësit e gaztë të lartpërmendur (shih fig.6.)




Fig.6 . Përqendrimet e ndotësve të gaztë në ajër

Projekti i monitorimit me pajisje portabel, aktualisht është në fazën e mbledhjes së mostrave të PM10 dhe me pasë këto mostra do të dërgohen për analizë në një laborator të akredituar jashtë vendit për percaktimin e metaleve të renda ne përmbajtjen e grimcave PM10. Ne fig.7 janë paraqitur pamje të filtrave nga rastet e mostrimit në 4 lokacionet : Çikatovë e vjetër, Lagja e Feronikelit, Gllabarë dhe Çikatovë e re.




Fig.7. Pamje e mostrave të PM10 nga 4 lokacionet e monitorimit me pajisje portabël

Konkluzionet

- ✓ Nga analiza e rezultateve të prezentuara më lartë mundë të themi se problem parësorë për cilësinë e ajrit në Drenas paraqitet tejkalimi i vlerave standade të lejuara me PM10 dhe të cilat bëjnë që cilësia e ajrit në këtë zonë të jetë jo e kënaqëshme.
- ✓ Në ngritjen e përqëndrimit të PM10 në ajër, kontribuojnë shkarkimet nga: transporti, industria, përdorimi i lëndëve djegëse për ngrohje dhe aktivitetet tjera antropogjene.
- ✓ Tejkalime të vlerave standarde të lejuara për ndotësit e gaztë sikur janë: SO₂, CO, NO₂ dhe O₃ nuk janë paraqitur asnjëherë gjatë periudhës për të cilën jemi duke e shqyrtuar.
- ✓ Është konstatuar se gjatë sezonit dimërorë përkeqësohet gjendja e cilësise së ajrit si shkak i ndikimit të kushteve meteorologjike dhe rritjes së konsumit të drurit dhe thëngjillit së lëndë djegëse për ngrohje.